



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.4, datë 28.01.2021

PËR

VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË TRE OBJEKTEVE BANIMI, PRONË PRIVATE (PALLAT), NDODHUR NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 3 DHE NR. 4, DURRËS, NË ZBATIM TË EKSPERTIZËS TË THELLUAR, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr. 97/2019, VKM nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**


1. Vijimin e procedurës të prishjes së detyruar të tre objekteve banimi, pronë private (pallat) ndodhur në Njësitë Administrative nr. 3 dhe nr. 4, në zbatim të ekspertizës të thelluar, hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, sipas tabelës si më poshtë vijon:

Objekte	Nr. Kati	Adresa	Gis	Konkluzion i Institutit Ndërtimit	Grupi i Punës	Njësia Administrative
Pallati Nr 27	6 Kate	Rruga Hysen Myshketa Pallati Nr 27	23180	Prishje	Dhimitri Papa, Armenda Gramos	Njësia Administrative Nr.3
Pallati 122	8 Kate	Rruga Aleksander Goga Pallati 122	20368	Prishje	Dhimitri Papa , Armenda Gramos	Njësia Administrative Nr.4
Pallati Nr 32	5 Kate Plus Podrum	Rruga Hysen Kertusha Pallati Nr 32	22799	Prishje	Altin Bidaj, Irakli Premti	Njësia Administrative Nr.3

2. Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të vendimit nr. 887/2019, të Këshillit të Ministrave.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merret të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, si dhe afishohet në këndin e njoftimeve pranë Njesisë Administrative nr. 3 dhe nr. 4.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës dhe Drejtoria e Kabinetit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi





U shpall sot me datë 28.01.2021


PLANVENDOSJA



PLANVENDOSJA



PLANVENDOSJA




RRUGA HYSEN KERTUSHA

GJ. ISMAIL GEMALI

ABDULLA GRIMCI

GJIR KOBRA

SHAPERS
KONSTRUKTOR



2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 89/ prot.
4



Durrës, më 02.02.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 04 datë 28.01.2021 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të tre objekteve banimi, pronë private(pallat), ndodhur në Njësinë Administrative Nr 3 dhe 4 Durrës, në zbatim të ekspertizës së thelluar hartuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

